



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1396 Prot.

Tiranë, më datë 18.11.2022

VENDIM

Nr. 531, datë 18.11.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 18.11.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e Relacionit për gjetje rastësore “Projekti Xhamia e Plumbit, Shkodër” hartuar nga Sektori i Shërbimit Arkeologjik, IKTK;
2. Të realizohet gërmimi dhe dokumentimi i gjetjeve rastësore nga specialistët e DSHA, në bashkëpunim me specialistët e DRTK Shkodër;
3. Raporti i gërmimit dhe dokumentimit të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Eugen KALLFANI

KRYETAR

Elyza MARGARITI

